



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E INSPEKSIONIT

RAPORTI I PUNËS

2020

Faqe 1 prej 16

Adresa: Rr. "Nuhi Gashi" • 11000 Podujevë

Tel: 038/200 41-010 • <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>

<https://kk.rks-gov.net/podujeve/drejtorite-2/inspeksion/raporti-per-vitin-2020/>

RAPORT PUNE I INSPEKSIONIT TË TREGUT

Duke marre parasysh inspeksionin e tregut si një mekanizëm i rëndësishëm që mbikëqyrë zbatimin e ligjeve të tregtisë për vitin 2020 kanë vepruar komfor dispozitave ligjore të tregut të cilët zbatojnë mbikëqyrjen inspektuese duke u bazuar në ligjet, rregulloret:

Ligjin për Inspeksionin e Tregut

Ligjin për Tregtinë e Brendshme

Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorëve

Ligji për Njësitet Matëse

Ligji për Zejtari

Ligji për Veprimtaritë Hoteliere dhe Turistike

Udhëzim Administrativ Nr.2005/12 për Përmbushjen e Kushteve Minimale Teknike për Lokalet Afariste Objektet e Shitjes me Shumice dhe Pakice dhe për Ndërmjetësimin në Tregti Rregulloren Komunale mbi Caktimin e Orarit të Punës për S/A për territorin e Komunës së Podujevës

Rekomandimet e Këshillit Drejtoreve

Bashkëpunimi me Institutin e Metrologjisë Legale të Kosovës për kontrollimin dhe vulosjen pompave të derivateve të naftës

12. Si dhe dispozitat e caktuara të ligjeve të tjera që i referohen inspeksionit të tregut.

13. Urdhëresat administrative në kohë të pandemis nga MEPTINIS.

PASQYRA TABELARE

Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NUMRI
1.	Inicim për gjykat	2
2.	Procesverbale	556
3.	Inspektime Përbashkëta	1120
4.	Aktvendime	1
5.	Informata, raporte	348
6.	Asgjësim i mallit	40.50 Euro
7.	Gjoha mandatorë	14
8.	Mbyllje të S/A	2

RAPORT PUNE I INSPEKSIONIT TË NDËRTIMIT

Me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës dhe realizimit sa më konkret të detyrave të parashtruara për zbatimin sa më efikas të Ligjit të Ndërtimit Nr.04/L-110, Ligjin për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës dhe planifikimit hapësinor dhe ndërtimit Nr.04/L-175, Udhëzimin Administrativ i MMPH nr.05/2017 për Standardet Minimale dhe Procedurat për Mbikqyrje Inspektive dhe lëshim të Certifikatës së përdorimit dhe Udhëzimin Administrativ MMPH nr.20/2013 për mënyrën, Procedurën dhe Shumën e Gjobave ndaj Pjesmarrësve në Ndërtim dhe ligjet e tjera të aplikueshme në punën e Inspeksionit të Ndërtimit që rregullojnë ndërtimin e objekteve të ndryshme ndërtimore të personave fizik e juridik në teritorin e Komunës së Podujevës, Inspektori i Ndërtimit pranë Kuvendit Komunal të Podujevës harton këtë raport pune:

Gjatë kësaj kohe raportuese Inspektori i Ndërtimit si prioritet ka pasur parandalimin e ndërtimeve pa leje (ilegale) në veqanti, në parandalimin e ndërtimeve në pronën shoqërore dhe private, ruajtjen e vijës së ndërtimit përgjatë brezit rrugor, evitimin e të metave të ndryshme gjatë ndërtimit tek objektet me leje etj. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe raportuese ka pasur një numër të ndërtimeve të objekteve banimore individuale, ndërtime të komplekseve banimore afariste, të objekteve afariste, të objekteve me karakter fetar, sanime të objekteve, adaptime, renovime etj.

Inspektori i ndërtimit ka bërë evidentimin e të gjitha këtyre punëve ndërtimore duke marrë edhe masa tjera të nevojshme në mënyrë që të ndikoj tek pronarët (investitorët) e këtyre ndërtimeve që të paisen me dokumentacion teknik-leje përkatëse për ndërtim, pëlqime paraprake etj. nga organi kompetent gjegjësisht nga Kuvendi Komunal. Inspektimet tona të vazhdueshme në teren, përmes hartimit të procesverbalit, gjobave mandatore dhe vendimit kanë detyruar dhe ndikuar që shumica e ndërtuesve të objekteve pa leje të evidentuara të aplikojnë për tu paisur me leje ndërtimi, disa nga ta edhe i kanë përfunduar procedurat dhe janë paisur me leje. Megjithatë kemi pasur ndërtues të cilet nuk i kanë përfillur urdhërat e inspektorit për ndërprerje të punimeve dhe për këto raste janë derguar kërkesat për kundervajtje Gjykatës Themelore, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni për Kundervajtje Prishtinë, Dega në Podujevë dhe në Prokurori Themelore, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal në Prishtinë dega në Podujevë dhe kallzime penale në Prokurorisë Themelore, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal në Prishtinë

Inspektori i Ndërtimit ka bërë kontrolla të vazhdueshme edhe tek ndërtimet me leje të objekteve me karakter individual, kolektiv, fetar etj. që të siguroj mbarëvajtëjen e punëve ndërtimore në përputhshmëri të plotë me lejën e ndërtimit, projektin kryesor, përdorimin adekuat të produkteve ndërtimore si dhe evitimin e të metave të ndryshme gjatë ndërtimit. Dhe në rastet kur kemi evidentuar ndonjë shkelje gjatë ndërtimit, me kohë i kemi njoftuar palët duke kërkuar nga pjesmarrësit në ndërtim (mbikqyrësi, punëkryesi, investitori) që brenda një afati të caktuar të bëjnë evitimin e këtyre të metave. Në disa raste ku kemi hasur në shkelje të mëdha si ndryshim gabariti (ndryshimet të lejuara $\pm 2\%$ sipas UA 05/2017), mbindërtime, shkelje të vijës së ndërtimit dhe të ngjashme kemi bërë rrethimin me shirit, mbylljen e vendndërtimit, gjobë mandatore dhe nxjerrjen e vendimeve për kthimin e vendit në gjendjen e mëparshme. Gjithsej kemi pasur një rast, te cilit i është kërkuar te bëjnë plotësim ndryshimin e lejës dhe harmonizimin me gjendjen faktike. Investitori i ka përfunduar procedurat dhe është paisur me leje ndërtimi. Kemi identifikuar tri mbindërtime të

objekteve afariste, të cilët nuk janë paisur me leje për mbindertim pasi që komuna nuk e ka aprovuar ende Hartën Zonale.

Gjithashtu gjatë kohës raportuese kemi kryer inspektime të rregullta në teren për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të ndryshme të qytetarëve dhe kompanive siç janë kërkesat dhe ankesat për ndalim të ndërtimeve pa leje dhe me leje, të objekteve afariste dhe të banimit, mbindërtimeve, objekteve fetare, mureve mbrojtëse dhe mureve rrethuese të pronës si në pronë publike ashtu dhe në atë private, të cilat përmes procesverbalit, vendimit dhe raportit me përgjigje për palën, në të cilat sipas rastit i kemi dhënë sygjërimet, kemi bërë zgjidhjen e kërkesës/ ankesës duke evituar pengesat e paraqitura në afat optimal.

Me kërkesë nga drejtoritë tjera janë kryer rrënime me qëllim të lirimit të hapsirave për ndërtimin e projekteve kapitale si psh. Rrënimi dhe lirimi i hapsirës në rrugën “Zahir Pajaziti” (Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi). Ky aksion është udhëhequr dhe ekzekutuar nga DPKGJ, ku inspektori i ndërtimit dhe komunal kanë pasur vetëm rol asistues. Lënda nuk është ekzekutuar.

Inspektori i Ndërtimit ka marrë pjesë edhe në inspektime të përbashkëta në aksionet e ndërmara nga Drejtoria e Inspeksionit për ndalim shfrytëzimit të hapsirave publike dhe trotuareve nga shitësit ambulant dhe largimin e shitësve të masës drusore dhe thëngjillit nga vendi joadekuat për në lokacionin ku bëhet shitja e tyre. Gjithashtu Inspektori i Ndërtimit ka qenë në kontrolla dhe aksione të ndryshme në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Inspektorët tjerë.

Inspektori i ndërtimit gjat kësaj kohe raportuese ka kryer edhe punë dhe detyra të tjera sipas kërkesave të palëve dhe shkresave Administrative të lëshuara nga Asambleja Komunale, Ekzekutivi dhe Drejtoria e Inspeksionit.

Inspektori i ndërtimit ka bërë mbi 1000 kontrolla inspektuese duke i llogaritur edhe ato me inspektorë të tjerë, mbi 250 vetëm në fushën e ndërtimit, 103 Raporte (ditore, mujore, 3 mujore, 6 mujore, njoftime dhe informata), hartuar 117 procesverbale, 27 aktvendime, ka konstatuar se janë ndërtuar gjithësejt 29 objekte nga konstruksioni i fortë pa leje ndërtimi, 43 leje ndërtimi, 4 objekte me leje të ndërtimit nga viti paraparak, 2 rrënime me leje, 17 objekte të rrethuara me shirit identifikues dhe vendosja e shenjës identifikuese „Vendndërtim i Mbyllur”, janë shqiptuar gjithësejt 13 gjoba mandatore. Poashtu kemi pasur 3 ndërtime me leje të ndërtimit që kanë shkelur kushtet dhe kriteret e lejës së ndërtimit duke mbindërtuar.

Nga ndërtuesit e objekteve pa leje të evidentuara të cilët kanë aplikuar për tu paisur me leje ndërtimi, gjashtë (6) i kanë përfunduar procedurat dhe janë paisur me leje ndërtimi.

Nga DPUMM kemi pranuar gjithësejt 43 leje ndërtimi për 4 nga të cilat janë pranuar vetëm Vendimi i lejës së ndërtimit (Është pranuar vetëm Vendimi i lejës së ndërtimit pa dokumentacionin teknik të aprovuar).

Me vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe ligjin për masat anti Covid të gjithë inspektorët pavarësisht nga fushat të cilat i mbulojnë kemi qenë të obliguar të punojmë për monitorimin dhe inspektimin e respektimit të vendimeve në teren në periudhën prej 13 mars 2020 deri në fund të vitit 2020. Inspektori i ndërtimit përveq me inspektorët e DI dhe Policinë e Kosovës ka kryer inspektime në teren edhe me inspektorët nga Ministria e Shëndetsisë dhe nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe inspektorët sanitare të vendosura në komunë nga Ministria e Shëndetsisë.

Në vitin 2020 jemi përballur me pandeminë Covid 19 dhe me riorganizim nga drejtoria kemi qenë të fokusuar në monitorimin e zbatimit të masave anti Covid duke punuar në dy ndrrimet dhe si pasojë nuk kemi pasur mundësi ti realizojmë knaqshëm të gjitha planet e parapara nga inspeksioni i ndërtimit për vitin 2020. Mirpo, duke pasur parasysh rëndësinë e fushës të cilën e mbulojmë jemi munduar maksimalisht që ndërtimi të mos lihet anash sikurse që edhe shihet në formën tabelare të inspektimeve.

PASQYRA TABELARE

Nr.	Përshkrimi i Punëve	Nr.
1.	Kontrolla inspektuese të rregullta të përbashkëta me inspektorin komunal, tregut, veterines, mjedisit dhe grupin për COVID-19.	>1000
2.	Kontrolla inspektuese të rregullta për ndërtime pa leje	~250
3.	Procesverbale	117
4.	Raporte ditore, javore, punes, planprogramit, informata dhe njoftime	103
5.	Rrënim me leje	2
6.	Ndërtime pa leje	29
	Aplikuar për leje ndërtimi	17
	Paisur me leje ndërtimi, Pelqim	6
	Refuzuar	6
7.	Aktvendime për nderprerje të punimeve	15
8.	Aktvendime për kthim të gjendjës së mëparshme	4
9.	Aktvendime për rrënim	8
10.	Rrethim me shirit identifikues dhe vendosja e shenjës „Vendndërtim i Mbyllur,,	17
11	Vizitë zyrtare	2
12.	Tejkalim gabariti nga objektet me leje ndërtimi	3
13.	Kërkesa të palëve	14
14.	Thirrje palës	2
15.	Kërkesa për kundërvajtje	1
16.	Kallzime penale	3
17.	Gjoha mandatore	13
	Gjoha mandatore të shqiptuara në vlerë totale 3500€ Të paguara 3500€	13

18.	Lëndë dërguar drejtorive tjera	8
19.	Aksion i përbashket me inspektorët dhe Policinë e Kosovës për largimin e masës drusore dhe thëngjillit	2 ditë
20.	Aksion i përbashket me inspektorët dhe Policinë e Kosovës për lirimimin e trotuarit në Tregun e Gjelbërt	2
21.	Leje të pranuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, viti 2020	43
22.	Inspektim në Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit	2

RAPORT PUNE I INSPEKSIONIT TË MBROJTJES SË MJEDISIT

Përmes këtij raporti do t'ju njoftojmë shkurtimisht për punët e kryera gjatë kësaj periudhe kohore.

Këto punë të kryera janë të bazuara në ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret komunale mbi inspeksionin e mbrojtjes së ambientit siç janë:

Ligji nr.03/L-025 Për Mbrojtjen e Mjedisit.

Ligji nr.04/L-060 Për Mbeturina

Ligji nr.03/L-160 Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

Ligji nr.02/L-102 Për Mbrojtje nga zhurma

Ligji nr.2004/24 Për Ujërat e Kosovës

Udhëzimi Administrativ MMPH nr.01/2017 Për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale

Udhëzimi administrativ 06/2018 Për ndëshkim me gjoba mandatorë

Rregullorja komunale për Mbrojtje të Mjedisit nr.01-352/11-0084560/19

Rregullorja Komunale për menaxhimin e mbeturinave nr.01-352/11-0084561/19

Inspektori i Ambientit në periudhën raportuese ka mbikëqyrë në mënyrë të vazhdueshme nivelin e mbrojtjes së ambientit në qytet.

Në mënyrë të vazhdueshme është mbikëqyrë menaxhimi i mbeturinave nga Kompania regjionale "Pastrimit" njësia operative Podujevë, si dhe Sh.P.K"Natyra"

Inspektori i Ambientit ka ndërmarrë fushatë të gjerë të vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me rëndësinë e ruajtjes së ambientit me theks të veçantë hapësirave gjelbëruese të cilat kanë rëndësi të madhe për thithjen e dyoksidit të karbonit (CO₂) dhe lirimimin e oksigjenit(O₂).

Anëtar i komisionit profesional për vlerësimin e drunjëve dekorativ në sheshin e qytetit.

Pjesëmarrja në projektin identifikimi i deponive ilegale në bashkëpunim me GIZ-in dhe AKMM-në.

Pjesëmarrja në aksione të përbashkëta me inspektorët tjerë dhe policinë.

Kontrolle të përbashkëta me inspektorët e lëmive tjera.

Nga dt.12.03.2020 deri më sot, në kohë pandemie kemi punuar në grupe çdo të dytën ditë për çka insp. i Tregut ka raportuar në mënyrë elektronike rregullisht.

Për këto punë të kryera kemi hartuar procesverbale, informata, përgjigje të kërkesave të palëve etj.

Paraqitja tabelore e punëve të kryera gjatë kësaj periudhe kohore.

PASQYRA TABELARE

Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NUMRI
1.	Kontrolle inspektuese të rregullta të përbashkëta	297
2.	Procesverbale	83
3.	Aksione të përbashkëta me policinë	102
4.	Informata	264
5.	Ankesa-Kërkesa të palëve	16
6.	Gjoha mandatore	04

RAPORT PUNE I INSPEKSIONIT TË VETERINËS

Kontrolla te rregullta ne keto veprimtari:

Dyqanet e Mishit (Mishtore), Dyqanet Ushqimore,Restorante,Gjelltove,Qebaptore,dhe Ambullanta Veterinare, Kontrolla të kafshëve para therrjes në therrtove, Kontrolla dhe vulosje te mishit ne therrtove.

Në **Dyqanet e mishit (Mishtoret)**,Inspektori Veterinare ka ber kontrolla te vazhdueshme duke piksynuare qe te arrihet ndalimi i shitjes së mishit të pa kontrolluar dhe pa vulosur nga inspektori veterinaresi dhe ruajtja e mishit dhe produkteve të tije të bahet në kushte të përshtatëshme për kët veprimtari ky piksynim është arriture. (zbatimi i Udhzimit Administrativ Nr.09/2005).

Në **Dyqne USHQIMORE** jan kryer kontrolla të shumta në bashkpunim me inspektor të tjerë me qëllim që të sigurohet që mallrat që tregtohen te jenë të sigurta për konsum, me afat të duhur,të ruajtura në kushte të përshtatshme. Në kët veprimtari jane arritur rezultate të mira. (Ligjii Ushqimit Nr.03/L-016).

Në **Restorante,Gjelltove,Qebaptore,Hamburgeri dhe Burektore** Jane kryer kontrolla me qellim që të sigurohet që ushqim i cili i shërbehet konsumatorit të jët i kontrolluar dhe i ruajtur sipas kushteve të parapara. (Lixh i Ushqimit Nr.03/L-016).

Kontrolla dhe vulosje të mishit në therrtove, çdo her qe ka pasur kafshe për therrje inspektori i veterinar ka bër kontrollimin e tyre me qëllim të përcaktimit se a jan të përshtatshme (të shëndosha)për therrje ,është ndaluare therrja e kafshëve jo të shëndosha.Pas therrjes dhe procesit të par hjekjes së lëkurs dhe organeve të brendshme jan kontrolluar të gjitha karkasat me rigorizitet të madhë me qëllim të arritjes në përfundim dhe konkludim se MISHI a është i përshtatshëm për konsum,pas vlersimit është bër vulosja e mishit me vulë zyrtare dhe paisja me vertetim të gjendje shëndetsore të mishit.

Ne periudhën raportuese numri i kafshëve te kontrolluara dhe mishit të vulosur është gjithsejt:2.586 krer, Shuma e mjeteve të inkasuara nga ky shërbim është:12.529.00 euro.

Lidhur me shëndetin e kafshëve, - Në kuadër të shërbimit Veterinar u inspektua marrja e Gjakut Gjedheve për analiza ndaj Smundjeve infektive gjithsejt: 208 mostra gjaku, nga te cilat 18 rezultuan positive me smundjen e Brucellozes, u ndëmarrën masat: u azgjaskan në

vendin e caktuar (f.sh. Përpellac) nga kompanija e “Zhvillimi”, në bashkpunim me inspektorët e AUV, u pregadit dokumentacioni i duhur për kompenzim.

Në Ambullanta Veterinare, në këtë veprimtari inspektori veterinar ka inspektuar shërbimet e kryera, barnat që përdoren dhe dhe kushtet e ruajtjes së tyre.

U kontrollua lidhur me Matrikulimine Gjedheve, ku për vitin 2020 janë matrikulua

Gjedhe: 823 krer

Dele: 764 krer dhe

U kontrolluan masat proventiv si:

Vaksionimi I kafshëve të imta DELE dhe DHI kundër smundjes së Brucellozës, u vaksionuan gjithsejt :2030 krer.

Vaksionimi I GJEDHEVE kundër smundjes GUNGORE (LSD), u vaksionuan gjithsejt: 2030 krer.

Pjesmarrja në aksione

Insp.Veterinar në bashkpunim me inspektorët e lëmive tjera ka ndërmarre masat kundër Pandemis Covid 19 (ligji 07/L006) dhe Vendimeve të **Qeveris**.

Insp.Veterinar ka ndërmarre Aksion në bashkpunim me insp. Tjer dhe SHPK:

Ndalimin e therrjeve të gjedhev me rastin e Bajramit të madhe qytet të Podujevës

Menagjimin dhe largimin e mbetjeve shtazore në Fshatin: Kërpimëh, në këtë aksion u arrit që nga vendi i therrjes dhe tregtimit të mishit të merren si dhe asgjashohen mbetjet e Kafshëve nga kompania: “Pastrimi” dhe “Natyra”.

PASQYRA TABELARE

Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NUMRI
1.	Procesverbale	116
2.	Inspektime	750
3.	Informata	112
4.	Kërkesa	13
5.	Kontrolla dhe vulosje të mishit	2.586 krer
6.	Mjete të inkasuara nga kontrolla dhe vulosja e mishit	12.529 euro
7.	Gjedhe të asgjasuara	18

RAPORT PUNE I INSPEKSIONIT TË KOMUNIKACIONIT

Gjatë kohës raportuese inspektori i komunikacionit rrugor punën e vet e ka zhvilluar në bazë të Ligjit mbi transportin rrugor të Republikës së Kosovës Nr.04/L-179 të dt.16 maj 2013, si dhe Ligji nr.06/L-070 të dt:14.09.2018 për ndryshimin dhe plotsimin e Ligjit nr.04/L-179, Udhëzimit Administrativ, Rregullors Komunale mbi transportin urban dhe urbano periferik të udhëtarëve si dhe planit të angazhimit të automjeteve në trafik nga ana e Drejtorisë për Inspeksion, Shërbime publike dhe Ambient.

Gjatë periudhës raportuese prioriteti i inspektorit të komunikacionit rrugor ka qenë transporti i rregullt i qytetarëve, nxënësve dhe udhëtarëve të tjerë me kohë duke u bazuar

në licenca të punës ,rendet të udhëtimit si dhe mbrojtja e kompanive transportuese nga transportuesit e egër dhe pa leje pune.

Transporti i qytetarëve në komunën tonë zhvillohet në të gjitha drejtimet në fshatra - lagje dhe në qytet me autobusa , minibusa,kombibusa 8+1 dhe autotaxi 4+1 dhe i njeiti inspektohet rregullisht nga inspektori i komunikacionit rrugor me qrast janë hartuar procesverbale , janë dhënë vrejtje, aktvendime mbi ndalimin e komunikacionit,si dhe aktvendime mbi eliminimin e të metave në komunikacion dhe konfiskimin e automjeteve. Krejt kjo me qëllim të një transporti të rregullt bashkëkohor dhe modern të udhëtarve.

Në komunën tonë transportin e udhëtarve e kryejnë : 22 kompani në drejtim Podujevë – Prishtinë, 13 autobusë në linjat urbane dhe urbano – periferike, 22 minibusa në lokale , me tepër se 30 kombibus si dhe me tepër se 27 autotaxi 4 + 1 të cilët punën e vet e kryejnë në bazë të licencave dhe rendit të udhëtimeve. Këtë vit kemi tre operator Radio Taxi Llapi, Radio Taxi Meritoni si dhe Radio Taxi Deni të cilët i plotsojn të gjitha kriteret dhe kushtet teknike për transportin e rregullt të udhëtarëve por të njejtve iu është caktuar vend qëndrimi për kohësiht ku marrin udhtar.Një pjesë e kombibusëve kanë qenë të angazhuar nga ana e Drejtorisë së Arsimit për bartjen e nxënëve nga disa lagje të caktuara ku nuk kanë patur transport dhe atë në bazë të tenderit të shpallur.

Transportin e udhëtarve në komunën tonë e kryejnë edhe kompanitë e ndyshme të licencuara nga MI të Kosovës në linjat ndërkombëtare të cilat kalojnë nëpër territorin e komunës sonë dhe në mungesë të kapacitetit të stacionit të autobusëve nuk kalojnë nëpër stacion dhe mbikëqyrjen e bëjnë inspektort e MI-së në bazë të kompetencave me Ligj.

Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës inspektori i komunikacionit rrugor ka organizuar inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme, e posaqërisht në linjat Podujevë-Prishtinë, Podujevë – Kërpimëh – Pollatë, Podujevë – Dumnicë, Podujevë – Lluzhan dhe Podujevë – Bradash, si dhe në të gjitha drejtimet tjera me qëllim të mbikëqyrjes së plotë dhe eliminimit të transportuesve pa leje pune. Këto aksione i kemi marrë edhe në qytet në orët e hershme të mengjesit, gjatë ditës dhe në orët e mbrëmjes, me qëllim të lirimit të trotuareve nga parkimet e pa lejuara për t’iu mundësuar lëvizja e lirë e qytetarve, me ç’rast janë hartuar procesverbale, janë dhënë vrejtje dhe është bërë largimi imenjëhershëm i automjeteve nga parkingjet e pa lejuara .

Gjatë periudhes raportuese të bashkëpunimit me inspektorët tjerë jemi angazhuar në inspektimin e transportuesve të mallrave të ndryshme me kapacitet deri në 12 ton, transportuesve tjerë të lire, transportuesve me qira, si dhe transportuesve me rërë , zhavor dhe transportuesve të cilët bëjnë mirëmbajtjen e rrugëve, ku janë marrë masa adekuate dhe janë hartuar procesverbale me shkrim, janë dhënë vrejtje dhe të njejtat i janë dërguar organeve gjyqësore.

Gjat periudhës raportuese Inspektori i komunikacionit rrugor ka bërë 958 kontrolla inspektuese të rregullta të përbashkëta, 17 procesverbale,25 inspektime të jashtëzakonshme në bashkpunim me Policinë e Kosovës, 18 urdhëresa nga Drejtoria , 123 informata, 06 raporte, 03 kërkesa dhe ankesa nga palët, 07 Aktvendime për komfiskimin e automjeteve prej 48orve që kryejn transport ilegal si ,16 vendim-gjobë mandatore të shqiptuar , 01 programi i punes si dhe 03 krkesa për fillimin e procedurave përmbarrimore.

Për kundër të gjitha këtyre problemeve kemi arritur që transportin e udhëtarve dhe të mallrave ta vejmë nën kontrollë të plotë dhe në suaza ligjore. Gjatë periudhës raportuese inspektori i komunikacionit rrugor ka kryer punë dhe detyra me inspektorët tjerë në drejtorinë e Inspeksionit në bazë të urdhëresave të Kuvendit Komunal, Ekzekutivit,

Drejtorisë për Inspeksion, Urbanizëm, Sherbime Publike dhe Ambient si dhe në bazë të kërkesave të qytetarve.

Për normalizimin e plotë të gjendjes në transportin publik të udhëtarve propozoj që Drejtoria për Urbanizëm, Inspeksion, Sherbime Publike dhe Ambient, Policia e Kosovës dhe institucionet tjera relevante e krejt kjo me qëllim të një transporti modern dhe bashkëkohor të udhëtarve , inspeksioni i komunikacionit rrugor rekomandon;

1. Stacioni i autobusëve nga i cili startojnë kompanitë e transportit publik, ndërurban nuk ka kapacitet ti pranojë edhe kompanitë urbano dhe urbano-periferik e mos të flasim për kompani ndërkombëtare , mundësisht të gjindet një vendparking nga ku do të startojnë kompanitë komunale të transportit të udhëtarve dhe në këtë mënyrë do të lirohej ngarkesa e tepërt e komunikacionit në qytet.

2. Të caktohen vend parkingjet për autotaxi 4 + 1, kombi 8+1 – minibusa për të gjitha linjat në komunë.

Pas shfaqjes së rastit të par me Covid-19 në Kosovë, IKSHP-ja dhe MSH-ja kanë nxjerrur disa urdhresa lidhur me transportin në tërë teritorin e Kosovës ku me qerast kemi ndërmar të gjitha masat për zbatimin me përpikri të urdhresave brenda teritorit të komunës së Podujevës.

PASQYRA TABELARE

Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NUMRI
1.	Kontrolla inspektuese të rregullta të përbashkëta	958
2.	Procesverbale	17
3.	Urdhëres nga Drejtori	18
4.	Inspektime të jashtëzakonshme në bashkpunim me Policin e Kosovës	25
5.	Informata	123
6.	Raporte	06
7.	Kërkesa të palëve dhe urdhëresa	03
8.	Vendim - gjobë mandatore të shqiptuar	16
9.	Programi i punës	01
10.	Kërkesa për kundurvajtëje	00
11.	Kërkes për fillimin e procedurave përmbartimore	03
12.	Aktvendime për komfiskimin e automjeteve prej 48orve që kryejn transport ilegal të udhëtarve	07

RAPORT PUNE I INSPEKSIONIT TË KOMUNIKACIONIT

Gjatë kohës raportuese inspektori i komunikacionit rrugor punën e vet e ka zhvilluar në bazë të Ligjit mbi transportin rrugor të Republikës së Kosovës Nr.04/L-179 të dt.16 maj 2013, si dhe Ligji nr.06/L-070 të dt:14.09.2018 për ndryshimin dhe plotsimin e Ligjit nr.04/L-179, Udhëzimit Administrativ, Rregullors Komunale mbi transportin urban dhe urbano periferik të udhëtarëve si dhe planit të angazhimit të automjeteve në trafik nga ana e Drejtorisë për Inspeksion, Shërbime publike dhe Ambient.

Gjatë periudhës raportuese prioritet i inspektorit të komunikacionit rrugor ka qenë transporti i rregullt i qytetarëve, nxënësve dhe udhëtarëve të tjerë me kohë duke u bazuar në licenca të punës, rendet të udhëtimit si dhe mbrojtja e kompanive transportuese nga transportuesit e egër dhe pa leje pune.

Transporti i qytetarëve në komunën tonë zhvillohet në të gjitha drejtimet në fshatra - lagje dhe në qytet me autobusa, minibusa, kombibusa 8+1 dhe autotaxi 4+1 dhe i njejt i inspektohet rregullisht nga inspektori i komunikacionit rrugor me qrast janë hartuar procesverbale, janë dhënë vrejte, aktvendime mbi ndalimin e komunikacionit, si dhe aktvendime mbi eliminimin e të metave në komunikacion dhe konfiskimin e automjeteve. Krejt kjo me qëllim të një transporti të rregullt bashkëkohor dhe modern të udhëtarëve.

Në komunën tonë transportin e udhëtarëve kryejnë : 22 kompani në drejtim Podujevë – Prishtinë, 13 autobusë në linjat urbane dhe urbano – periferike, 22 minibusa në lokale, me tepër se 30 kombibus si dhe me tepër se 27 autotaxi 4 + 1 të cilët punën e vet e kryejnë në bazë të licencave dhe rendit të udhëtimeve. Këtë vit kemi tre operator Radio Taxi Llapi, Radio Taxi Meritoni si dhe Radio Taxi Deni të cilët i plotsojnë të gjitha kriteret dhe kushtet teknike për transportin e rregullt të udhëtarëve por të njejtve iu është caktuar vend qëndrimi për kohësiht ku marrin udhtar. Një pjesë e kombibusëve kanë qenë të angazhuar nga ana e Drejtorisë së Arsimit për bartjen e nxënësve nga disa lagje të caktuara ku nuk kanë patur transport dhe atë në bazë të tenderit të shpallur.

Transportin e udhëtarëve në komunën tonë e kryejnë edhe kompanitë e ndyshme të licencuara nga MI të Kosovës në linjat ndërkombëtare të cilat kalojnë nëpër territorin e komunës sonë dhe në mungesë të kapacitetit të stacionit të autobusëve nuk kalojnë nëpër stacion dhe mbikëqyrjen e bëjnë inspektorët e MI-së në bazë të kompetencave me Ligj.

Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës inspektori i komunikacionit rrugor ka organizuar inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme, e posaqërisht në linjat "Podujevë-Prishtinë", "Podujevë-Kërpimëh-Pollatë", "Podujevë-Dumnice", "Podujevë-Lluzhan" dhe "Podujevë-Bradash", si dhe në të gjitha drejtimet tjera me qëllim të mbikëqyrjes së plotë dhe eliminimit të transportuesve pa leje pune. Këto aksione i kemi marrë edhe në qytet në orët e hershme të mëngjesit, gjatë ditës dhe në orët e mbrëmjes, me qëllim të lirimit të trotuareve nga parkimet e pa lejuara për t'iu mundësuar lëvizja e lirë e qytetarëve, me ç'rast janë hartuar procesverbale, janë dhënë vrejte dhe është bërë largimi i menjëhershëm i automjeteve nga parkingjet e pa lejuara.

Gjatë periudhës raportuese të bashkëpunimit me inspektorët tjerë jemi angazhuar në inspektimin e transportuesve të mallrave të ndryshme me kapacitet deri në 12 ton, transportuesve tjerë të lire, transportuesve me qira, si dhe transportuesve me rërë, zhavor dhe transportuesve të cilët bëjnë mirëmbajtjen e rrugëve, ku janë marrë masa adekuate dhe janë hartuar procesverbale me shkrim, janë dhënë vrejte dhe të njejtat i janë dërguar organeve gjyqësore.

Pas shfaqjes së rastit të par me Covid-19 në Kosovë, IKSHP-ja dhe MSH-ja kanë nxjerrur disa urdhresa lidhur me transportin në tërë territorin e Kosovës ku me që rast kemi ndërmarrë të gjitha masat për zbatimin me përpikëri të urdhresave brenda territorit të komunës së Podujevës. Po ashtu nga data 13.03.2020. kemi vepruar në grupe, inspektor të lamive të ndryshme për ta

parandaluar hapjen e virusit Covid – 19, gjithashtu kemi dale në teren me inspektorët nga Ministria e Shëndetshis lidhur me parandalimin e infektimit të qytetarëve me virusin Covid-19. Për normalizimin e plotë të gjendjes në transportin publik të udhëtarve propozoj që Drejtoria për Urbanizë, Inspeksion, Shërbime Publike dhe Ambient, Policia e Kosovës dhe institucionet tjera relevante e krejt kjo me qëllim të një transporti modern dhe bashkëkohor të udhëtarve , inspeksioni i komunikacionit rrugor rekomandon:

1.Stacioni i autobusëve nga i cili startojnë kompanitë e transportit publik, ndërurban nuk ka kapacitet ti pranojë edhe kompanitë urbano dhe urbano-periferik e mos të flasim për kompani ndërkombëtare, mundësisht të gjindet një vendparking nga ku do të startojnë kompanitë komunale të transportit të udhëtarve dhe në këtë mënyrë do të lirohej ngarkesa e tepërt e komunikacionit në qytet.

2.Të caktohen vend parkingjet për autotaxi 4 + 1, kombi 8+1 – minibusa për të gjitha linjat në komunë.

PASQYRA TABELARE

Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NUMRI
1.	Kontrolla inspektuese të rregullta të përbashkëta	815
2.	Procesverbale	27
3.	Urdhëresë nga Drejtori	11
4.	Inspektime të jashtëzakonshme në bashkpunim me Policinë e Kosovës	30
5.	Informata	86
6.	Raporte	06
7.	Kërkesa të palëve dhe urdhëresa	04
8.	Vendim - gjobë mandatore të shqiptuar	00
9.	Programi i punës	01
10.	Kërkesa për kundërvajtje	00
11.	Kërkes për fillimin e procedurave përmbarimore	00
12.	Aktvendime për komfiskimin e automjeteve prej 48orve që kryejnë transport ilegal të udhëtarve	00
13.	Kërkesa për kundërvajtje Covid-19 të cilat janë proceduar te zyrtari ligjor për të marrë masa me insp.Sanitare	01
14.	Inspektime te perbashketa me Policinë e Kosoves dhe Inspektorët e shëndetshisë për respektimin e masave COVID – 19	45

RAPORT PUNE I INSPEKSIONIT TË SHËRBIMEVE KOMUNALE

Inspeksioni komunal gjatë kohës raportues ka bërë kontrolla dhe inspektime të rregullta lidhur me Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës me sa vion:

Ligji nr.07/L-006 të dt. 14 gusht 2020 –PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E PANDEMISË COVID -19 NË TERITORIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, RREGULLORRE PËR ORARIN E PUNËS PËR BIZNESET QË POEREJNË NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS me nr.01-311/05-0007450/20 të DT.31 janar 2020dhe RREGULLORE PËR SHËRBIME PUBLIKE KOMUNALE me nr.01/155-352 të dt.6 gusht 2013.

Gjatë kësaj kohe raportuese inspektori komunal ka bërë përcjellëjen e kompanisë për mirëmbajtëjen e rrjetit të ujrave të zeza dhe atmosferike e gjithashtu edhe mirëmbajtjen e pusetave të ujrave të zeza dhe atyre atmosferike se sapo i kryejnë shërbimet komunale sipas kontratave.

Gjithashtu inspektori komunal gjatë kësaj kohe raportuese ka mbikqyrë kompaninë Regjonale të Ujësjellësit njësia operative në Podujevë lidhur me furnizimin dhe cilësinë e ujit të pijshëm, mirëmbajtëjen e pusetave të ujrave të zeza, mirëmbajtëjen dhe rregullimine qdo gypi të dëmtuar të rrjetit të ujësjellësit e për të gjitha këto inspektori komunal ka urdhëruar puntorët e KUR Prishtinë-njësia operative në Podujevë që të i mirëmbajnë dhe të i pastrojnë të gjitha kanalet dhe pusetat e mbyllura nga mbeturinat nëpër të gjitha rrugët e qytetit.

Inspektori komunal gjatë kësaj kohe raportuese në bashkëpunim me puntorin e autorizuar të KUR-së ka mbikqyrë të gjitha autolarjet në teritorin e komunës së Podujevës se a janë të kyqura në rrjetin e ujësjellësit apo në puse (bunare) me hidrofor e ku kanë konstatuar se shumica gjegjësisht të gjitha autolarjet janë të furnizuara me ujë nga puset (bunaret). Inspektori komunal gjatë kësaj kohe raportuese ka inspektuar në grup me të gjithë inspektorët ku është përfshirë në të gjitha inspektimet dhe hartimin e procesverbaleve.Gjatë kësaj kohe raportuese Inspektori komunal ka inspektuar në lirimimin e tretuarëve dhe hapsirave publike nëpër të gjitha rrugët e qytetit duke sygjeruar dhe hartuar procesverbale dhe vrejtëje me shkrim.

Gjithashtu inspektori komunal ka inspektuar KEDS Divizionin e rrjetit distrikti në Prishtinë lidhur me projektin – zavendësimin e shtyllave të drurit në ate të betonit,montimi i kabllit nëntoksor, montimi i ormanave dhe montimi i trafove (Blindë) nëpër të gjitha rrugët e qytetit dhe fshatrave dhe aty ku ka hasë në pengesa të implementimit të projektit ka bërë procesverbale dhe vrejtëje me shkrim duke i obliguar që të mos pengohet projekti. Inspektori komunal ka shqyrtuar edhe të gjitha ankesat të cilat janë drejtuar kësaj Drejtorie gjegjësisht Inspektorit për shërbime komunale.

Vlen të theksohet se nga data e Pandemisë (inspeksioni me specifikat e veta),inspektori komunal ka qenë në punë dhe detyra të caktuara nga Drejtori i Drejtorisë duke i kryer punët në përpikëri me Ligjet, Vendimet dhe urdhëresat e Qeverisë së Republikës së Kosovës për mbarëvajtëjen e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve gjatë emergjencës së shëndetit publik.

PASQYRA TABELARE

NR.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NUMRI
1.	procesverbale	118
2.	Kërkesa të palëve	25
3.	Kontrolla Inspektues të përbashkëta	750
4.	Thirrje për palën	18
5.	Aktvendime	02
5.	Informata	13
6.	Gjoha mandatore	01

RAPORT PUNE I INSPEKSIONIT TË BUJQËSISË

Bazuar në kompetencat, ligjet, udhizimet administrative dhe rregulloret mbi punën e inspeksionit, siç janë:

Ligji nr.03/L-029 Për Inspeksionin Bujqësor.

Ligji nr.2003/5 Për Farërat në Kosovë

Ligji nr.2003/10 Për Plehtrat Artificiale

Ligji nr.04/L-120 Për Mbrojtjen e bimëve

Ligji nr.03/L-016 Për Ushqimin

Ligji nr.04/L-114 Për pasurimin e miellit.

Udhëzimi Administrativ MBPZHR nr.07/2013 Prë standardin e cilësisë së miellit.

Udhëzimi Administrativ 02/2004 Për tregtim të Plehrave artificiale.

Udhëzimi Administrativ nr.04/2003 Për tregtimin e farërave në Kosovë.

Kontrolla e vazhdueshme e ruajtjes së tokës bujqësore.

Kontrolla të rregullta të lokaleve afariste që merren me furnizimin e fermerëve me repromaterial bujqësor (Barnatoret bujqësore).

Përcjellja e përgatitjeve për mbjellje Pranverore dhe dhënja e këshillave profesionale për evitimin e mundshëm të pengesave gjatë kësaj fushate.

Po ashtu kemi edhe një bashkëpunim të mirë me Drejtorinë e Bujqësisë, ku shpeshherë jemi në komisione të përbashkëta mbikëqyrëse në terren lidhur me projektet përfituese për fermerë në lëmi të ndryshme bujqësore që kjo drejtori iu ka shpërndarë fermerëve si dhe subvencionet që kanë marrë fermerët llapjan nga M.B.P.ZH.R-ja Prishtinë.

Pjesëmarrja në aksion të përbashkët me inspektorët tjerë.

Pjesëmarrja në komisione të ngitura nga Drejtoria e Administratës lidhur me pranimin e punëtorëve të rinj në punë, si dhe nga Drejtoria e Bujqësisë.

Në pylltari aksione të ndryshme të masave drusore, pas orarit të punës s'bashku me punëtorët e pylltarisë dhe policinë.

Kontrolla tek mullinjtë dhe Sillosi lidhur me përgatitjet për grumbullimin e grurit. Gjatë kësaj periudhe kemi pasur edhe inspektime të përbashkëta me inspektorët e lëmimeve tjera sidomos me atë të Ambientit dhe të tjerë.

Pjesëmarrja në aksione të përbashkëta me Policinë.

Nga dt.12.03.2020 deri më sot për shkak të Pandemisë kemi punuar në grupe çdo të dytën ditë, ku insp.i Tregut ka raportuar në mënyrë elektronike rregullisht.

Inspektimi është bër për zbatimin e vendimeve dhe Ligjit anti Covit miratuar nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës.

Paraqitja tabelore e punëve të kryera gjatë kësaj periudhe kohore janar-qershor të vitit 2020.

PASQYRA TABELARE

NR.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NUMRI
1.	Kontrolla të përbashkëta	205
2.	Procesverbale	43
3.	Aksione të përbashkëta me Policinë	64
4.	Informata	116
5.	Raporte pune	02

RAPORT PUNE I INSPEKSIONIT TË PYLLTARISË

Në cilësinë e inspektorit të Pylltarisë, nga dt 03.01.2020, kam inspektuar terenet Bellosicë – Marincë.

Nga dt.25.02.2020 kanë filluar zjarrëvënjet e qëllimëshme në pyje publike dhe private, ku kanë përfshire keto zona malore:

Bellosice,Marincë, Brecë, Zhiti,Herticë,Turuqicë,Shajkovc,Surdullë.

Nga dt.15.03.2020 ka filluar Pandemia Covid.19, ku dhe ka filluar mbyllja totale,dhe nga kjo dt. Inspektorët jemi ndarë në grupe dhe kemi punar në zbatimet, vendimet e Qeverisë anti Covid 19.

Deri me 31.12.2020 kohë pas kohe jam angazhuar edhe në detyrat e mia si inspektor i Pylltarisë si psh, inspektime rrugore kontrollë ne terene,qarkullimin e sasisë drunore, kontrollimin e Fletepercjelljeve te lshuara nga Rojet e Pyjeve.

PASQYRA TABELARE

NR.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NUMRI
1.	Procesverbale	61
2.	Konfiskim i sasisë Drunore	47.78 m³
3.	Për Gjykatë Penale	1
4.	Për Gjykatë Kundërvajtje	14
5.	Vizita Teren	28
6.	Inspektime Rrugore	61
7.	Zjarre në pyje	9
8.	Angazhime te përbashkta ispektime Covid 19	175

RAPORT PUNE I INSPEKSIONIT TË ADMINISTRATËS

Gjatë kësaj periudhe kohore, kam kryer punë dhe detyra administrative të Drejtorisë së Inspeksionit, si dhe detyra që më janë dhënë nga Drejtori – Shefja e Inspeksionit.

Kam bërë raporte, plane, kërkesa, pëlqime, përmbledhje të materialit, printim dhe fotokopjim të lëndëve.

Kam menaxhuar palë që kanë ardhur për kërkesa dhe ankesa dhe i kam deleguar, varësisht të sektoret adekuate.

Kam protokoluara lëndët varësisht që më janë ofruar nga inspektorët ose Drejtori apo Shefja.

Kemi bërë procedimin e Kërkesave për Kundervajtje në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, në bashkëpunim me Zyrtarin Ligjor 134 sosh, për mos rrespektimin e masave anti Covid-19, të dërguar nga Policia e Kosovës. Iu kam ndihmuar inspektorëve në shtypjen e raporteve ditore, javore, mujore e vjetore varësisht kur më kanë kërkuar ndihmë.

Me.21.01.2021 kam hartuar Raportin vjetor të punës.

Me dt. 05.01.2021 kam protokoluara ankesën së qytetarëve në fshatin Sfeqël, si dhe shqyrtimin e ankesës së qytetarëve në fshatin Lupq, Marrveshje NNP “Vllëzërit Sahiti” fshati Revuqë

Kërkesë për Pëlqim Sanitar nga ETC më 14.01.2021

Kërkesë për heqjen e pengesës - Inspektori i ambientit 11.01.2021

Kam bërë përmbledhjen e raporteve ditore, javore, mujore dhe vjetore të secilit inspektor, në mënyrë fizike dhe elektronike si dhe Planin Vjetor të punës për secilin inspektor veq e veq, përmbledhjen dhe printimin.

Bashkë me Remziun –Zyrtar Administrativ kemi mbajtur evidencën e secilës palë që ka hyrë në Drejtorinë e inspeksionit, ndërsa ato të cilat kanë ardhur në sektore jo të dhura, i kemi udhëzuar për në drejtoritë tjera, varësisht në sektoret adekuate dhe i kemi ndihmuar të orientohen nëpër drejtoritë ku u referohen kërkesat dhe problemet që kanë.

VËREJTJE: Për shkak të Pandemisë Covid 19, në vitin paraprak me Vendim të Qeverisë, një kohë të gjatë kam qenë e liruar nga puna, për shkak të sëmundjes sime kronike që kam. Prandaj puna dhe aktiviteti im si zyrtarë administrative në Drejtorinë e Inspeksionit ka qenë cunguar dukshëm.

RAPORT PUNE I INSPEKSIONIT TË ADMINISTRATËS

Që nga fillimi i Dhjetorit për qdo ditë kam punuar në detyrat që më janë shtruar nga Drejtori dhe Shefja duke zbatuar kërkesat e tyre për punë të ndryshme administrative si dhe duke bashkëpunuar me Drejtorin në kordiniminin e kërkesave dhe adresimin e ankesave të qytetarëve me Drejtoritë tjera relevante në mënyrë që të jemi sa më me efikasitet të zgjidhjeve të ankesave të qytetarëve, por edhe kam bërë kryerjen shumëzimit e kopjimit e materialeve administrative të nevojshme për punët e sektorëve të ndryshëm mbrenda Drejtorisë ashtu kam pritur dhe përcjellur shumë persona (palë) qoftë për të kërkuar zgjidhjen e ndonjë problem personal që i përket domenit të Drejtorisë tonë por jo vetëm sepse kemi pasur disa raste të cilat nuk ishin në kompetencat e tona por jemi munduar të udhëzojmë në sektorët kompetent për trajtim sa më të shpejt. Po ashtu kam pritur dhe përcjellur edhe musafir tjerë të cilët kanë shprehur dëshirë ta takojnë Drejtorin për qështje krejt private ose shoqërore, për këtë kam edhe listën me emra të palëve kontaktuese në evidencën e punëve ditore. Gjithashtu kemi mbajtur edhe kordinuar raporte pune edhe me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, atë të Urbanizimit, zyren e personelit për qështje administrative tjera të lidhura me sektorin e drejtorisë tone.